



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE
FUSHË - KRUJË

**RAPORTI I MONITORIMIT
TË PLANIT TË INTEGRITETIT
PËR VITIN 2025**

Mars, 2026.

TABELA E PËRMBAJTJES:

HYRJE.....	5.
1.MONITORIMI DHE RAPORTIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT.....	5-8.
2. RISQET E INTEGRITETIT DHE VLERËSIMI I TYRE.....	8-9.
3. MASAT PËR MENAXHIMIN E RISQEVË TË INTEGRITETIT.....	9.
4. MONITORIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT.....	9.
5. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME.....	10.

QTTB Fushë-Krujë - Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë-Krujë

PI - Plan Integriteti

DAP - Departamenti i Administratës Publike

MVRI - Metodologjia e Vlerësimit të Riskut të Integritetit

PT - Programi i Transparencës

HYRJE

Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) Fushë-Krujë, prej vitesh ka vënë në prioritet dhe do vazhdojë në mënyrë të pandalur të ketë një vullnet të palëkundur në luftën kundër korrupsionit, përmes aksioneve parandaluese, masave ndëshkuese dhe aktiviteteve ndërgjegjësuere. Miratimi i Planit të Integritetit është një përpjekje për të hedhur themelet e një sistemi më të gjerë, i cili menaxhon risqet që kërcënojnë integritetin institucional.

Qëllimi i hartimit dhe miratimit të këtij dokumenti është krijimi i një mjedisi që nxit dhe promovon kulturën e integritetit, duke rritur kapacitetin e institucionit tonë për zbatimin e sistemeve të testimit të integritetit. Objektivat kryesore që synohet të arrihen janë kryerja e proceseve dhe vendosja e rregullave të qarta mbi aspekte të integritetit në QTTB Fushë-Krujë, në mënyrë që të minimizohet çënimi i institucionit tone nga risqet e integritetit

Plani i Integritetit të QTTB Fushë-Krujë, është konceptuar dhe bazuar në Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023 dhe në Planin e Veprimit 2024-2026, në zbatim të saj në objektivin specifik A9 në lidhje me “Forcimin e integritetit të nëpunësve publikë” konkretisht në zbatimin e masës A.9.4 mbi “Hartimin, miratimin dhe zbatimin e Planeve të Integritetit nga të gjitha institucionet e varësive të ministrive” për vitin 2025. Në kuadër të realizimit të këtij Plani Integriteti, është mundësuar kryeja e procesit të vlerësimit të riskut të integritetit sipas Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut të Integritetit.

Plani i Integritetit për Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) Fushë-Krujë, u hartua gjatë periudhës Janar 2025 – Dhjetor 2025. Ky plan është hartuar duke u mbështetur në dokumentin e Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut të Integritetit (MVRI) për qeverisjen qendrore.

Qëllimi i Planit të Integritetit në këtë institucion është:

- Vlerësimi i risqeve të integritetit të cilat komprometojnë aftësinë e QTTB Fushë-Krujë për të kryer funksionin në mënyrë të paanshme dhe të përgjegjshme.
- Studimi i faktorëve që mund të mbështesin apo rrisin risqet e vlerësuara.
- Formulimi i masave të përshtatshme për adresimin e tyre.

I. METODOLOGJIA E MONITORIMIT DHE RAPORTIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT

1.1 Grupi i Punës për Hartimin e Planit të Integritetit

Emër Mbiemër	Pozicioni
Fatjona Dalliu	Kryetar, Specialist Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse
Shpresa Demirxhiu	Anëtar, Përgjegjës i Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse
Andi Kodra	Anëtar, Specialist Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse

Për procesin e vlerësimit të riskut të integritetit në institucionin e QTTB Fushë-Krujë u përdorën dy metoda:

- **Metoda cilësore**, përmes zhvillimit të një workshop-i orientues për procesin e vlerësimit të riskut të integritetit me grupin e punës së ngritur dhe stafin e QTTB Fushë-Krujë si dhe takimeve të fokusuara me stafin e QTTB-së.

Takimet e fokusuara shërbyen:

- Për të identifikuar proceset e punës në fusha të veprimtarisë së institucionit të cilat janë të ekspozuara ndaj shkeljeve të integritetit;
- Për të identifikuar sjelljet joetike e joprofesionale dhe parregullsive të tjera;
- Për të vlerësuar risqet e integritetit dhe faktorët e tyre në kuadër të këtyre proceseve.

Procesi u shoqërua edhe më një analizë të kuadrit të brendshëm rregullator të QTTB Fushë-Krujë (shqyrtim literature), i cili përfshin: urdhra, manuale, rregullore dhe akte të brendshme. Gjithashtu, u hulumtuan raporte të ndryshme mbi veprimtarinë e QTTB Fushë-Krujë si, p.sh.: raporte të auditit të brendshëm, raporte monitorimi, raporte vjetore, matrica e riskut financiar etj.

- **Metoda sasiore**, përmes vlerësimit me anë të një ankete të strukturuar, ku punonjësit e QTTB Fushë-Krujë u përgjigjën pyetjeve mbi çështje të veçanta të integritetit dhe etikës në institucion. Anketimi përfshiu një kampion me 61 punonjës të institucionit me nivel besueshmërie statistikore 95%, shkalla e vlerësuar e gabimit është +/- 2%. Për të krijuar një larmishmëri më të madhe në analizë, kampionimi përfshiu një shpërndarje më të gjerë në lidhje me gjininë,

moshën dhe vjetërsinë në punë. Pyetësorët e strukturuar u plotësuan në mënyrë anonime nga stafi i QTTB Fushë-Krujë.

Monitorimi ishte periodik dhe përfshin kryerjen e aktiviteteve nga ana e punonjësve/grupeve të punonjësve përgjegjës, për zbatimin e masave të miratuara në PI. Monitorimi përcakton nëse këto masa të zbatuara kanë qenë eficiente, nëse kanë evidentuar ndryshime të kontekstit të institucionit apo ndryshime të vetë risqeve, të cilat mund të kërkojnë rishikimin e masave ekzistuese dhe prioritetëve të risqeve (planit të veprimit), si edhe nxjerrjen e mësimëve për planifikim më të mirë në të ardhmen.

Raportimi është një procedurë e rregullt që siguron zbatimin e planit të integritetit për risqet e integritetit sipas afateve kohore të parashikuara. Ky proces ndiqet nga personi përgjegjës, i caktuar nga titullari i institucionit, i cili është përgjegjës për progresin e zbatimit.

Frekuenca minimale e raportimit është brenda një periudhe gjashtëmujore. Raportimi i lejon titullarit të ndërmarrë me kohë masa përmirësuese, në rast se zbatimi i ndonjë mase të caktuar ka sjellë vështirësi apo vonesa.

1.2 Progresi në Zbatimin e Planit të Integritetit

• Objektivat Strategjike 2023-2025

Nr.	Objektivi
1	Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe forcimi i kapaciteteve njerëzore në lidhje me etikën dhe integritetin.
2	Zbatimi dhe realizimi në kohë i projekteve të miratuara nga MBZHR.
3	Përmirësimi i sistemit të arkivimit, ruajtjes së dokumentacionit, administrimin e dokumentave dhe informacionit.

Objektivi 1. Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe forcimi i kapaciteteve njerëzore në lidhje me etikën dhe integritetin.

• **Gjendja aktuale:** Struktura e institucionit ka 61 punonjës, nga të cilët 12 pozicione janë vakante dhe 1 i pezulluar.

• **Përmirësime:**

- Raportim periodik në MBZHR për plotësimin vendeve vakante;
- Dërgimi periodik i kriterëve për të përcaktuar kandidatët që i përshtatet nevojave të institucionit tek DAP;
- Lidhja e kontratave të përkohshme të punës me studentë ekselentë;
- Rritja e realizimit të trajnimeve në ASPA;

- Përfshirja, në rregulloren e brendshme të institucionit, e detyrimit për kryerjen e analizës vjetore të nevojave për trajnim, si dhe vlerësimin e ndikimit të trajnimeve.
- **Sfida:** Nevoja për plotësimin e vendeve vakante dhe forcimi i kapaciteteve teknike të stafit.

Vlerësimi i progresit: 85% i zbatimit të masave.

Objektivi 2: Zbatimi dhe realizimi në kohë i projekteve të miratuara nga MBZHR.

- **Gjendja aktuale:** Janë kryer të gjitha raportet vjetore mbi ecurinë e projekteve dhe janë dorëzuar në MBZHR bashkë me produktet e punës.
- **Përmirësime:** Janë rritur kërkimet në fermë, demonstrimet në fermë, trajnimet me SEB-et dhe AREB-et dhe fermerë të tjerë të interesuar, asistencë teknike dhe ditët fushore.
- **Sfida:** Mungesa e mjeteve të lëvizjes ka ndikuar në mosrealizimin e shërbimeve të planifikuara nga drejtuesit e projekteve.

Vlerësimi i progresit: 95% i zbatimit të masave.

Objektivi 3. Menaxhimi i dokumentacionit dhe arkivimit.

- **Gjendja aktuale:** Dokumentacioni protokollohet dhe ruhet sipas rregullave në fuqi.
- **Përmirësime:** Janë zbatuar procedura më të standardizuara për administrimin e dokumenteve.
- **Sfida:** Duhet të rritet digjitalizimi i arkivës për të siguruar akses më të shpejtë dhe siguri më të madhe të informacionit dhe dorëzimi i dokumentave të prodhuara ndër vite.

Vlerësimi i progresit: 80% i zbatimit të masave.

Objektivi 4. Menaxhimi Financiar.

- **Gjendja aktuale:** Proçeset financiare ndjekin rregulloret përkatëse dhe nuk ka pasur shkelje të identifikuara.
- **Përmirësime:** Janë respektuar afatet për raportimin financiar dhe auditimet nuk kanë konstatuar parregullsi.
- **Sfida:** Rritja e transparencës në publikimin e raporteve financiare për interesin publik.

Vlerësimi i progresit: 90% i zbatimit të masave.

2. RISQET E INTEGRITETIT DHE VLERËSIMI I TYRE

QTTB Fushë-Krujë është institucion në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe funksionon sipas Rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë Krujë" të miratuar nga Ministri, ku përcaktohen qartë objektivat, prioritet strategjike të institucionit. Rregullorja mban nr. 748 Prot. datë 18.11.2020 dhe është përditësuar dhe e miratuar në MBZHR. Në këtë rregullore janë përfshirë edhe detyra në zbatim të Ligjit nr. 9131 datë 8.09.2003 "Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike". Kjo rregullore përmban ndër të tjera: përfshirjen e funksioneve/njësive që rrjedhin nga ligje të tjera, si ai për të drejtën e informimit apo njoftimit dhe konsultimit publik; njësisë së sinjalizimit apo konfliktit të interesit; përcaktimin e linjave të qarta të komunikimit dhe raportimit ndërmjet drejtorive të ndryshme; parashikimin e rregullave për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale etj. Institucioni ka ngritur gjithashtu njësinë përkatëse në institucion për çështjet që lidhen me integritetin.

Punonjësit janë njohur me ligjet dhe rregulloren e brendshme duke organizuar takime me punonjësit. Çdo fillim jave organizohet takimi i Titullarit me drejtuesit e Drejtorive/Sektorëve, të cilët, informacionet e reja jua komunikojnë stafit që kanë në varësi. QTTB Fushë-Krujë aktualisht nuk ka hartuar dhe miratuar dokumente strategjike institucionale posaçërisht për aspekte të integritetit, të tilla si: Kodi i Brendshëm i Etikës dhe rregullore për parandalimin e konfliktit të interesit në institucion. Kodi i Etikës si dhe kuadri rregullator i brendshëm duhet të parashikojë rregulla për procesin e deklarimit dhe pranimin të dhuratave, administrimit të regjistrimit përkatës apo përfitime të tjera të ngjashme, shpenzimet e mbuluara nga të tjerët; rregulla për pranimin e donacioneve/sponzorizime dhe funksionimin e regjistrimit përkatës; rregulla për deklarimin nga ana e zyrtarëve të institucionit të takimeve me lobistë apo grupe interesi; rregulla për veprimtaritë e jashtme të punonjësve dhe deklarimin e tyre; standarde sjelljes së punonjësve pas mbarimit të detyrës; rregulla për procedure e hetimit dhe shqyrtimit të sinjalizimeve dhe veprime ose praktika të dyshuara korrupsioni; rregulla të brendshme për deklarimin e pasurisë për funksionarët që janë subjekt deklarimi etj. Përmbledhja tërësore e vlerave dhe parimeve të Kodit të Etikës duhet të udhëheqë funksionarët e lartë të QTTB Fushë-Krujë në sjelljen dhe veprimet e tyre gjatë ushtrimit të funksioneve dhe angazhimeve.

Nr.	Fusha	Përshkrimi i Situatës	Risku i Integritetit
1	Menaxhimi financiar.	Nuk janë konstatuar probleme me dokumentacionin financiar, buxhetin apo prokurimet.	Pa risk
2	Menaxhimi i burimeve njerëzore.	Ka 12 pozicione vakante dhe 1 i pezulluar	Risk i lartë
3	Arkivimi dhe administrimi i dokumenteve.	Dokumentacioni është i unifikuar, me protokoll dhe arkivim sipas rregullave.	Pa risk
4	Zbatimi dhe realizimi i projekteve.	Nevojitet më shumë mbështetje logjistike për specialistët e institucionit.	Risk i mesëm

3. MASAT PËR MENAXHIMIN E RISQEVË TË INTEGRITETIT

Nr.	Masa e Marrë	Afati	Përgjegjësi
1	Kërkesa MBZHR dhe DAP për shpalljet e vendeve vakant.	2025	Titullari i QTTB Fushë-Krujë
2	Kërkesë në PBA 2025-2027 për investimin blerje mjeti për përmirësimin e infrastrukturës për specialistët në terren.	2025-2027	Titullari i QTTB Fushë-Krujë
3	Rritja e transparencës në procesin e menaxhimit të burimeve njerëzore.	2025	Kryetari i Integritetit
4	Monitorimi i rregullt i planit të integritetit.	Çdo 6 muaj	Kryetari i Integritetit

4. MONITORIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT

Aktiviteti	Frekuenca	Përgjegjësi
Mbledhja e të dhënave për zbatimin e planit	Çdo 6 muaj	Grupi i monitorimit.
Raportimi i progresit	Vjetor	Titullari i QTTB Fushë-Krujë

Publikimi i rezultateve	Çdo vit	Institucioni dhe MBZHR
-------------------------	---------	------------------------

5. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Nga të dhënat marra nga grupi i monitorimit rezulton se:

- QTTB Fushë-Krujë ka bërë përparime të dukshme në masat e marra për zbatimin e Planit të Integritetit;
- QTTB Fushë-Krujë ka hartuar dhe miratuar rregulloren e brendshme të institucionit bazuar është ligji nr. 9131 datë 8.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike";
- Proçeset financiare ndjekin rregulloret përkatëse dhe nuk ka pasur shkelje të identifikuar;
- QTTB Fushë-Krujë ka miratuar rregulla të brendshme për funksionimin dhe administrimin e regjistrit të dhuratave në institucion, si dhe për deklarimin, origjinën dhe kontrollin e dhuratave të marra nga punonjësit e institucionit;
- Është ngritur njëسيا e parandalimit të konfliktit të interes. Kjo njësi ka hapur regjistrin e konfliktit të interesit dhe do të regjistrojë praktikën në përmbajtje të tij.
- Transparenca dhe monitorimi i brendshëm janë përmirësuar, por ka ende hapësirë për përmirësime në rekrutimin dhe digjitalizimin e shërbimeve;
- Institucioni ka një program të mirëfilltë dedikuar trajnimit për integritetin, sjelljen etike dhe zbaton rregulloren e ndjek trajnimet e ASPA-s për çështje të tilla;
- Nga analiza përmbajtësore e faqes zyrtare të internetit të QTTB -së, vihet re se publikohen të dhëna dhe informacion me karakter informues për të rritur transparencën për publikun.

Rekomandime:

- Menaxhimi i informacionit dhe dokumentacionit kërkon jo vetëm staf të informuar dhe më aftësistë e duhura, por edhe komunikim efektiv që respekton afatet kohore në sigurimin e informacionit. QTTB Fushë Krujë nuk ka një sistem të IT dhe ka nevojë për një specialist të IT në organikë që të jetë i angazhuar vazhdimisht me këtë proçes.

Grupi i monitorimit:

Fatjona DALLIU

Shpresa DEMIRXHIU

Andi KODRA

TITULLARI

Ilir SALILLARI

